

V E N D I M
Nr.99, datë 31.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtare e “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 30.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.100 Akti që i përket:

KËRKUESE: AVNI SHEHU, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.18

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. LUAN RAMA, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.18, përfaqësuar nga avokat Mirash Martini.
3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.18, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.196, datë 24.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Avni Shehu ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese ku pretendon se vendimi nr.196, datë 24.7.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.18, është i pambështetur në ligj e në prova e si i tillë duhet të shfuqizohet e për pasojë zgjedhjet në këtë zonë të shpallen të pavlefshme.

Nga shqyrtimi i materialeve të çështjes ka rezultuar e provuar se kërkuesi nuk rezulton të ketë bërë ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj vendimit nr.3, datë 22.7.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.18, që shpalli rezultatet e zgjedhjeve si dhe kandidatin fitues zotin Luan Rama. Në këtë mënyrë, kërkuesi është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese pa konsumuar mjetet e tjera ligjore të ankimit në rregull administrativ e për pasojë, në kuptim të nenit 131 shkronja “F” të Kushtetutës dhe neneve 107 e 140 të Kodit Zgjedhor nuk legjitimohet të bëjë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

Lidhur me këtë shkak, në kërkesën e tij kërkuesi pretendon se Kodi Zgjedhor, e sidomos neni 113 pika 5 dhe neni 141 pika 1 nuk e lidhin ankimin në Gjykatën Kushtetuese me ankimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Po sipas kërkuesit, në mbështetje të nenit 42 pika 2 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese duhet të ndërhyjë për të mbrojtur të drejtat kushtetuese për zgjedhje të lira e të barabarta.

Duke shqyrtuar këto pretendime, Gjykata shpreh se është pikërisht detyrimi kushtetues i parashikuar në nenin 131 shkronja “e” që e obligon Gjykatën Kushtetuese të merret me shqyrtimin e konflikteve në fushën elektorale. Por, kjo veprimtari e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të konceptohet

jashtë rregullave të tjera të përcaktuara nga Kushtetuta e nga Kodi Zgjedhor. Kështu, sipas Kushtetutës e pikërisht nenit 131 shkronja “f”, kërkesën për një proces të rregullt ligjor Gjykata Kushtetuese mund ta shqyrtojë pasi individit t’i jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e tyre. Në rastin konkret, nuk rezulton që kërkuesi të ketë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike e konkretisht ankimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj vendimit të Komisionit të Zonës Zgjedhore, bazuar në nenet 140 pika 2 dhe 141 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Kërkuesi në kërkesën e tij ka kërkuar që Gjykata Kushtetuese të shprehet për të gjitha shkeljet që ai ka parashtruar për zgjedhjet e datës 24 qershor, për ato të datës 8.7.2001 si dhe për raundin e dytë të zgjedhjeve të datës 22.7.2001.

Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese konkludon se kërkuesi në mbarim të çdo faze zgjedhje, me nxjerrjen nga ana e Komisionit të Zonës Zgjedhore dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të vendimeve përkatëse ka pasur të drejtë që në atë kohë t’i godasë ato për pavlefshmëri në kuptim të nenit 131 të Kodit Zgjedhor. Me kalimin e afateve ligjore e drejta për t’u ankuar është parashkruar për fazat e kaluara, duke mbetur efektive e drejta e ankimit vetëm për aktyet e mara gjatë e pas raundit të dytë, atë të datës 08.07.2001.

Megjithatë, ashtu siç u theksua më sipër edhe kjo kërkesë duhet të rrëzohet për mungesë legjitimitimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenet 131 shkronja “e, f” të Kushtetutës, neneve 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 140 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.